



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 5, datë 14.01.2021**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatores znj. Brunilda Kadi,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi i gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**


•  
•  
•  
•  
•  
•  
•

***EKSTRAKT***

**RAPORT**

---

**VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM  
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E {...}**



POLI I DREJTËSISË  
RRUGA "ANA KOMNENA"  
TIRANË

---

⋮

---

## QËLLIMI

---

Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, të gjyqtarës {...}, është hartuar bazuar në nenet 68, 89 e vijues dhe 171, pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit” dhe Vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”.

Vlerësimi etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit që ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, synon të përcaktojë nivelin e vlerësimit të gjyqtarit në përputhje me Metodologjinë e Pikëzimit, të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme etikën dhe aftësinë profesionale të gjyqtarëve, të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së gjyqtarëve, të zhvillojë karrierën e gjyqtarit bazuar në meritat profesionale, duke identifikuar gjyqtarët që kanë aftësi të veçanta profesionale, si dhe të identifikojë nevojat për trajnim profesional të gjyqtarëve me qëllim planifikimin efektiv të procesit të trajnimit vazhdues, si dhe për dhënien e kontributit në përmirësimin e strukturës organizative dhe funksionalitetin e gjykatave.

Burimet e vlerësimit në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën vlerësimit 2013-2016, analizohen duke mbajtur parasysh:

Përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës.”. Në referim të këtij neni, konkluzionet e arritura nga organet e rivlerësimit kalimtar lidhur me aftësitë e gjyqtarit, sipas grup kritereve të vlerësimit, duhet të konsiderohen si një nivel vlerësimi që nuk mund të cenohen duke përcaktuar një nivel vlerësimi më të ulët se sa është konkluduar nga organet e rivlerësimit me vendim të formës së prerë.

Konkluzionet e arritura në aktin e vlerësimit të përgatitur nga organi kompetent për vlerësimin e gjyqtarëve, nuk mund të rivlerësohen duke përcaktuar një nivel më të ulët vlerësimi. Kjo, duke pasur parasysh që burimet e vlerësimit, përveç 6 çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, janë të njëjta dhe i janë nënshtruar analizës së plotë dhe të gjithanshme në atë akt.



## VLERËSIMI DHE PIKËZIMI PËR AFTËSITË E GJYQTARES SIPAS KRITEREVE TË VLERËSIMIT

### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

#### 1-A Njohuritë ligjore.

*1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *”...Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Natyra e çështjeve që ajo ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe përfshin njohuri të së drejtës penale për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve (shih dokumentin 2 dhe 3, dosjen 1 dhe 2); njohuri dhe ka shqyrtuar veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare (shih dosjen 3 dhe 4); njohuri në interpretimin e ligjil civil për konfiskimin e pasurisë (shih dosjen 5). Një rëndësi të veçantë i kushtohet dhe respektimit ose jo të kërkesave të ligjit penal material, dispozitave ligjore të K.Penal, si në dosjen 3, ku Gjykata e Apelit nuk konstatoi ekzistencën e asnjë rrethane lehtësuese në rastin konkret, duke evidentuar shkelje apo në dosjen 2, ku Gjykata e Apelit, çmon se procesi gjyqësor në shkallë të parë është zhvilluar duke mos u respektuar jo vetëm dispozitat procedurale që lidhen me njoftimin e të pandehurit për seancat gjyqësore e posaçërisht për të drejtën e tij për t’u paraqitur personalisht në gjykim, por as ato që lidhen me të drejtën e të pandehurit për të zgjedhur mbrojtës gjatë gjykimit e për të realizuar në mënyrë efektive mbrojtjen e tij, me avokat të zgjedhur e të besuar prej tij....”*

.....

Nga vëzhgimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, evidentohet njohje dhe zbatim korrekt i ligjit penal si dhe dispozitave procedurale të referuara në mbështetje të vendimeve të ndërmjetme, gjatë zhvillimit të seancave dhe në përfundim të tyre. Në aspektin procedural, në 11 dosjet e vëzhguara, rezulton se përdoren referenca të sakta të dispozitave lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale.

Konstatohet se në të gjitha vendimet e vëzhguara, gjyqtarja ka identifikuar qartë natyrën e çështjes objekt gjykimi, duke i'u referuar fazave të procedimit penal, si dhe pretendimeve që qëndrojnë në themel të gjykimit në apel. Gjyqtarja njih dhe përdor dispozitat procedurale, që lidhen me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, me të drejtën e apelit në varësi të llojit të vendimit që është ankimuar, me mënyrën e procedimit të çështjes, me ndarjen e çështjeve, me gjykimin e shkurtuar, me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në apel, si dhe me marrjen, vlerën dhe fuqinë e provave të administruara. Ajo ka njohuri të sakta dhe identifikon në mënyrën e duhur dispozitat ligjore materiale mbi përgjegjësinë penale të autorit të veprës penale, mbi cilësimin juridik të faktit penal, mbi individualizimin e dënimit sipas rrethanave të çështjes, si dhe mbi aplikimin e alternativave të dënimit me burgim.

Gjyqtarja tregon vëmendje për cilësimin juridik të faktit penal dhe të pretendimeve të palëve. Ka aftësi për të evidentuar konfliktin e normave dhe jep arsyet kur veçantia e natyrës së çështjes kërkon një zbatim të ndryshëm të rregullave ligjore . Njih dhe përdor, kur është rasti, metodën e interpretimit pajtues të normave ligjore.

Në funksion të saktësisë të natyrës së çështjes, gjyqtarja ka përcaktuar saktë, jo vetëm faktin penal në përputhje me provat e administruara, por i ka kushtuar rëndësinë e duhur respektimit të kufijve të shqyrtimit të çështjes në apel, duke identifikuar me kujdes pretendimet e palëve.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, analizimin nga pikpamja e ligjit dhe e provave të vendimit të dhënë nga Gjykata.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi** ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

***1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“...Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, duke i bërë ato pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Përdorimi i referencave në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore, bëhet rregullisht nëpër vendime apo në dhënien e vendimeve të ndërmjetme, konstatohet referenca tek vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, sikurse është rasti i vendimit unifikues nr. 3/2011, lidhur me ardhjen e pasojës e cila është e ndërprerë për shkaqe të paparashikuara nga vullneti i të pandehurit, apo vendimi tjetër unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2/2003 për gjykimin e shkurtuar, si dhe vendimi unifikues nr. 4/2002, për heqje dorë nga ankimi (shih dokumentat 1, 2 dhe 3 si dhe dosjen 3). E njëjta gjë vlen edhe për përdorimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentin 2 dhe 3), apo të akteve ndërkombëtare, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar (shih dokumentin 2 dhe 3), si dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih dosjen 2)...”*

Nga të gjitha vendimet e vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Pas identifikimit të ligjit të zbatueshëm, ajo e zbaton atë, me arsyetim të qartë, duke bërë lidhje logjike të fakteve të mosmarrëveshjes me tekstin e ligjit. Njeh shumë mirë institutet e të drejtës penale procedurale dhe materiale, duke i zbatuar saktësisht në dhënien e vendimeve. Aftësitë e saj interpretuese bien në sy në çështjet procedurale që lidhen me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, me të drejtën e ankimit, me të drejtën e gjykimin të shkurtuar dhe me cilësimin juridik të veprës penale në raport me mosrëndimin e pozitës së të pandehurit. Po ashtu, ajo ka aftësi interpretuese edhe për ligjin material, tregon rastet kur është e nevojshme zbatimi i ligjeve të posaçme, duke bërë interpretimin e tyre, sipas natyrës së çështjes dhe pretendimeve të palëve.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor. Në vendimet e administruara në dosje, vihet re aftësia e gjyqtarës për të përdorur dhe analizuar jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Në vendimet përfundimtare, vihet re përcaktimi i saktë dhe i kuptueshëm i fakteve të çështjes, analizimi i tyre nga gjykata me e ulët, analizimi i shkaqeve të ankimit si dhe interpretimi i normave ligjore në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Për të treguar njohjen e parimeve, gjyqtarja i referohet edhe në gjuhën latine dhe shpjegon edhe në gjuhën shqipe përmbajtjen e tyre.

Gjithashtu, konstatohet se për interpretimin e ligjit, gjyqtarja i është referuar edhe jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Jurisprudenca e përdorur në vendime është e përditësuar dhe lidhet saktësisht me ligjin që interpreton në çështjen konkrete.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes.

⋮

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi** ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësi e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

## **I-B Arsyetimi ligjor**

### ***I-B-a Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se; *“Subjekti i rivlerësimit, harton vendime me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët gjatë gjykimit. Analiza ligjore është e thjeshtë, duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsytet se pse ajo zbatohet në rastin konkret. Në tekset e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në dosjen nr. 3, subjekti i rivlerësimit, pjesa arsyetuese përmban shkaqet pse masa e dënimit me burgim të përjetshëm për të pandehurin është masa më e përshtatshme, dënim ky që do të ulet në 35 vjet burgim, si pasojë e gjykimit në ritin e gjykimit të shkurtuar, neni 406/1 i K.Pr.Penale. Dispozitivi hartohet në tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rasteve të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin e fajësisë apo të pafajësisë gjer tek shpenzimet gjyqësore për palët”.*

Vendimet gjyqësore të vëzhguara janë të qarta dhe të kuptueshme, me gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme. Nuk evidentohen terma apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin apo të kontekstit në të cilin përdoren. Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive të shkurtra, të ndërthurura thjeshtë dhe lehtësisht të kuptueshme. Fjalitë janë në rrjedhë logjike me njëra tjetrën dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit po ashtu.

Në aspektin strukturor, vendimet kryesisht kanë ndjekur një strukturë të mirë përcaktuar duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (pjesa hyrëse, arsyetimi, pjesa urdhëruese). Pjesa arsyetuese e vendimit gjithashtu ndjek një strukturë të mirë përcaktuar duke u ndare në tri pjesë kryesore, ku secila prej tyre emërtohet në harmoni me përmbajtjen e saj, duke orientuar lexuesin dhe duke e bërë të qartë dhe të kuptueshëm vendimin.



⋮

Gjyqtarja përdor gjuhën teknike për shkak të përmbajtjes së ligjit të posaçëm apo për shkak të përmbajtjes së provave (aktet e ekspertimit). Kur përdor fjalë latine për koncepte kyçe teknike, ajo jep gjithnjë sqarimin në shqip të tyre.

Teksti i vendimeve është logjik dhe pa gabime. Përdor në mënyrë korrekte dhe konsistente termat teknike. Ajo respekton rregullat gramatikore, përfshirë edhe rregullat e sintaksës, si dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi** ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### ***I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se; *“Struktura e vendimeve të saj është e standardizuar. Ajo përmban në mënyrë të përgjithshme elementët e kërkuar nga legjislati procedural penal e civil. Kështu, në pjesën hyrëse, dokumenti 2 dhe 3, akuzat janë shënuar të plota për të gjitha veprat penale që akuzohet dhe baza ligjore përkatëse; në pjesën hyrëse të vendimeve në dosjet 1 dhe 4, janë shënuar gjeneralitetet e plota të pandehurve dhe adresat e tyre, ndërsa në dosjen 5 janë shënuar të plota gjeneralitetet e plota të palëve ndërgjyqëse, objekti i plotë dhe baza ligjore përkatëse. Pjesa arsyetuese hartohet në gjuhë të thjeshtë dhe me strukturë solide”.*

Gjyqtarja i harton vendimet e saj me strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar. Ajo ka një metodë të unifikuar për hartimin e vendimeve. Vendimet e vëzhguara respektojnë me rigorozitet strukturën formale me tre pjesë të vendimit penal, por edhe elementët e çdo pjese, siç përcakton neni 383 i Kodit të Procedurës Penale. Çdo vendim gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjyqësor dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës për Krime të Rënda, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

Ajo i kushton rëndësi pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve, në funksion të orientimit dhe kuptueshmërisë së tekstit prej lexuesit. Kjo pjesë është e ndarë me tituj të veçantë, duke treguar: (i)

ecurinë procedurale të çështjes; (ii) rrethanat e faktit penal, duke treguar edhe provat që e mbështesin atë; dhe (iii) dhe vlerësimin e Kolegjit Penal, që ka dhënë vendimin, ku paraqitet analiza e ligjit të zbatueshëm, në përputhje me faktet konkrete të çështjes, për të përfunduar me nxjerrjen e konkluzioneve.

*Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Përsa i takon dispozitivit të vendimit, gjyqtarja përdor teknikën e listimit të disponimeve pa i numërtuar ato, që vështirëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime.*

Paragrafët i harton të shkurtër, në funksion të një argumenti faktik apo juridik që parashtron. Në disa raste vendimet paraqiten voluminoze për shkak edhe të teknikës për referencë literale që përdor gjyqtarja, por ajo tregon kujdes që në pjesët e referuara të nënvizojë apo theksojë fjalitë dhe frazat që kanë rëndësi për çështjen.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi** ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### ***I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

*Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se; “Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cënuar nga gjykatat më të larta, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, tek 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme. Vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsytimi duke referuar saktë shkakun dhe bazën ligjore.”*

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara konstatohet se gjyqtarja ka aftësi në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Identifikon në mënyrë të plotë dispozitat ligjore. Ajo përcakton saktë faktin penal dhe zbaton ligjin në mënyrën e duhur, duke dhënë argumente të qarta për nxjerrjen e konkluzioneve. Analizon dhe individualizon përgjegjësinë penale të autorit të veprës penale, të drejtat e të pandehurit në procesin penal, rrethanat e faktit penal në përputhje me provat, si dhe rrethanat për caktimin e dënimit penal.

Gjyqtarja shqyrton shkaqet e ankimit dhe pretendimet e palëve mbi të, duke kryer një analizë gjithëpërfshirëse dhe duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në ankim, duke përfshirë edhe kërkesat procedurale. Jep arsye të qarta për konkluzionet që nxjerr, duke i kushtuar rëndësi edhe pretendimeve të palëve që nuk pranohen nga gjykata.

Citon dispozitën ligjore të zbatueshme dhe jep argumentet përse kjo dispozitë është e zbatueshme në çështjen konkrete. Kur është rasti, i plotëson argumentet e saj me referenca tek parimet e përgjithshme të së drejtës, si dhe tek jurisprudenca e gjykatave më të larta. Rrjedhimisht, të gjitha disponimet e gjykatës janë të lidhura me pjesën arsyetuese.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi** ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2. A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjithave çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi. Në këtë rast, vlerësimi do të bëhet vetëm mbi analizën e 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja. Nga vëzhgimi i tyre evidentohet se, për këto kategori çështjesh, ligji nuk ka parashikuar afate ligjore shqyrtimi. Në Kodin e Procedurës Penale, nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit dhe gjithashtu edhe për shqyrtimin në apel të kërkesave për konfiskimin e pasurisë në bazë të ligjit të posaçëm (shih dosjen 5). Në këto kushte, do të prezumohet se afati ligjor i gjykimin, është respektuar, dhe ky kriter do të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimin për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Sipas pikës 3 shkronja “j” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duhet të jetë në cilesinë e relatorit në jo më pak se 20 gjykime çështjesh penale në vit. Rrjedhimisht, bazuar në të dhënat e mësipërme mesatarja e gjykimin për subjektin {...} është 30 çështje penale në vit, ka qenë më i lartë se standarti sasior. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë e shpejtë, në intervale kohore nga 21 ditë (shih dosjen nr.5 konfiskim pasurie) deri në 4 muaj (shih dosjen nr.2 trafikim të narkotikëve). Në të tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimin ka qenë 24 ditë (shih dosjen nr.3), 1 muaj e 3 ditë (shih dosjen nr.4 dhe 2 muaj e 8 ditë (shih dosjen nr.1). Në të 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është respektuar afati ligjor (shih dosjen nr.5) apo ai standard i gjykimin (shih dosjet nr.1, 2, 3, 4). Gjykimi brenda afateve është konstatuar edhe tek 3 dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, ku është analizuar data e regjistrimit të çështjes në gjykatë në raport me datën e dhenies së

⋮

vendimit përfundimtar. Kështu, kohëzgjatja e gjykimit në këto 3 raste ka qenë 1 muaj e 4 ditë (shih dokumentin nr. 1), 2 muaj e 26 ditë (shih dokumentin nr. 2) dhe 3 muaj e 23 ditë (shih dokumentin nr. 3)...”.

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit rezulton se për 11 çështjet e vëzhguara, për të cilat nuk parashikohet afati ligjor gjykimi, dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas Vendimit nr.261/2 të KLD. Kryesisht gjykimi për 11 çështjet e përzgjedhura me short ka zgjatur nga 21 ditë (dosja nr.5) minimalisht, në 4 muaj (dosja nr.2) maksimalisht, por në çdo rast brenda standardit minimal kohor. Në 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim gjykimi ka zgjatur përkatësisht 1 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 26 ditë, 3 muaj e 23 ditë, duke respektuar standardin minimal kohor të përcaktuar dhe për pasojë, nuk rezulton asnjë çështje e shqyrtuar jashtë standardit minimal kohor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor është respektuar në të gjitha çështjet e analizuar.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

### ***2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e posaçme (Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në periudhën e vlerësimit). Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje në raport me standardin minimal kohor për kategori (të gjitha çështjet e marra në analizë janë çështje penale themeli me palë kundërshtarë), për 11 çështjet e përzgjedhura me short, dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për kategorinë e çështjeve “penale krime” dhe “gjykim i posaçëm, konfiskim,

...

sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009”, rezulton të jetë rreth 42 ditë. Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale të themelit në gjykatat e apelit, për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

### ***2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit të përbërë nga 4 vite kalendarike, rezulton se :

- Për periudhën 08.10.2013-28.05.2014, gjyqtarja ka ushtruar detyrën e pedagoges së brendshme në Shkollën e Magjistraturës dhe rrjedhimisht nuk ka ngarkesë pune në këtë periudhë.
- Në total në gjithë periudhën e vlerësimit (29.05.2014-31.12.2016), gjyqtarës {...} i janë caktuar në cilësinë e kryesueses 42 çështje penale themeli, 49 kërkesa penale për caktim mase sigurimi, 13 kërkesa të tjera penale (duke përfshirë këtu dhe çështjet e shqyrtuara në bazë të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, nëpërmjet masave për goditjen e pasurisë). Në vitin 2016 ka mbartur për vitin 2017 vetëm 1 kërkesë penale. Ka përfunduar 3 vitet e fundit të detyrës 35 çështje penale themeli, 48 kërkesa penale dhe 12 kërkesa të tjera penale.<sup>1</sup>
- Ndërkohë rezulton se ka përfunduar në gjithë periudhën e vlerësimit, sipas tabelave me të dhëna statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, 93 çështje në total. Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit si dhe mospërputhje të numrit të çështjeve të përfunduara në bazë të të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyruara në Raportin e analizimit të aftësive profesionale, mbetet e pamundur përlogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqene rendimenti 91.3 % i përcaktuar në faqen 26 të Raportit, faqe 1229 i dosjes së rivlerësimit.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e plotë të vlerësimit rezulton në masën 91.3 %.

---

<sup>1</sup>Faqe 26 i Raportit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale, faqe 1229 e dosjes së vlerësimit.

⋮

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësi e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Mesatare”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

### ***2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “...*Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} i kushton rendesi arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve, ndonëse në 2 raste vendimet janë arsyetuar jashtë afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale. Megjithatë, vonesa në këto dy raste ka qenë me vetëm 1 ditë dhe justifikohen me natyrën komplekse të vendimeve të dhëna, dosja 3, si dhe nga fakti që në rastin tjetër është tejkaluar afati i ankimit në gjykatën më të lartë. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej saj dy vendime pas një dite (shih dosjen 1 dhe 4), brenda 5 diteve nga shpallja (shih dosjet 2 ); dhe pas 11-13 ditëve (shih dosjen 3 dhe 5)...”<sup>2</sup>*

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 9.10.2020, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 02.09.2020, rezulton se:

- Dosja që i përket vendimit me nr. 77, datë 30.7.2014 është dorëzuar më datë 6.8.2014 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 71, datë 29.6.2015 është dorëzuar më datë 30.6.2015 (1 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 104, datë 9.11.2015 është dorëzuar më datë 10.11.2015 ( 1 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 22, datë 9.3.2016 është dorëzuar më datë 11.3.2016(2 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 4, datë 21.1.2016 është dorëzuar më datë 5.2.2016(15ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 30, datë 31.3.2016 është dorëzuar më datë 6.4.2016 (6 ditë).

---

<sup>2</sup>Faqe 27 i Raportit për analizimin e aftësive profesionale, faqe 1230 e raportit të vlerësimit.

Referuar të dhënave si më sipër, për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, koha mesatare e arsyetimit të vendimit rezulton të jetë 5.7 ditë.

Duke iu referuar dy kategorive të çështjeve, rezulton se për kategorinë “çështje penale themeli” (Dosja 1,2,3,4,6,7,8,9,10,11) koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 5 ditë, ndërsa për kategorinë “çështje me palë kundërshtarë, konfiskim” (Dosja 5) koha e arsyetimit të vendimit është 13 ditë.

Duke qenë se ;

- të dhënat për kohën e arsyetimit të vendimeve gjyqësore i referohen një numri të kufizuar çështjesh (vetëm 11 çështjet e përzgjedhura me short) dhe vetëm dy kategorive të çështjeve (çështje penale themeli dhe civile me objekt konsifikim),
- nuk ka informacion për kategorinë “kërkesa penale në fazën e hetimit”, “Kërkesa me objekt sekuestrimi ( sipas ligjit Antimafia) apo “ Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”,
- në 11 dosjet e vëzhguara, vetëm në 5 (pesë) raste kontatohet arsyetimi i vendimit tej afati ligjor 5 ditor, ndërsa në 6 (gjashtë) dosjet e tjera është i barabartë ose më i shkurtër se afati ligjor,

në tërësi, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton se është “Më e shkurtër se afati procedural të gjitha kategoritë e çështjeve” .

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

## **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

### ***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në të 5 çështjet gjyqësore, ajo ka marrë masat për planifikimin e seancës gjyqësore në kohën e duhur, duke respektuar edhe të drejtën e palëve për t’u përgatitur për gjykim. Në të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar respektimi i afateve ligjore të nenit 333 të K.Pr.Penale në caktimin e seancës së parë, si dhe në dërgimin e njoftimeve për palët. Po ashtu, në rastet kur gjykimi është zhvilluar me më shumë se 1 seancë, ajo ka planifikuar seancën e radhës përgjithësisht brenda afatit 15 ditor të përcaktuar nga neni



342/2 i K.Pr.Penale. Gjyqtarja {...} ka kryer veprimet e nevojshme për seancën gjyqësore, duke identifikuar saktësisht palët pjesëmarrëse për njoftimin në kohën e duhur të tyre. Ndër seancat e vëzhguara, numri i seancave në çështjet e themelit ka qenë e ndryshme. Kështu, dosja 5 ka përfunduar me 1 seancë produktive; dosja 4 ka përfunduar me 2 seanca dhe që të dyja kanë qenë produktive; dosja 3 ka përfunduar me 2 seanca, nga të cilat 1 ka qenë joproduktive dhe 1 produktive; dhe dosja 1 ka përfunduar me 3 seanca, nga të cilat 1 ka qenë joproduktive dhe 2 produktive, dhe dosja 2 me 7 seanca, nga të cilat 6 joproduktive dhe 1 produktive. Këto të dhëna tregojnë se nga 15 seanca gjyqësore të vëzhguara, 8 prej tyre kanë qenë joproduktive. Shkak i dështimit të seancave joproduktive kanë qenë mosformimi i trupit gjykues (shih dosjen 2), për shkak të dorëheqjes tre anëtarëve, dhe ngarkesa në punë e tre anëtarëve në përbërje trupit gjykues për gjykimin e kësaj çështje që kanë njoftuar gjykatën e Apelit për pamundësinë për t'u paraqitur për shkak të gjykimeve të tjera të paracaktuara deri në fund të muajit shtator në Gjykatën e Apelit Korçë (njëra nga anëtarët për arsye shëndetësore (1 seancë) në dosjen 1 për shkak të dorëheqjes së anëtarit të trupit gjykues dhe 1 seancë gjyqësore (shih dosjen 3) për shkak të mosshoqërimit të të pandehurit nga Drejtoria e Burgjeve ditën dhe orën e gjykimit. Në çeljen e seancave përgjithësisht ka pasur vonesë 31 minuta në dosjen 2, seanca e 7, për shkak se prokurori dhe tre anëtarët kanë qenë në një gjykim tjetër. Megjithatë, vonesa në fillimin e çeljes së seancës nuk ka shkaktuar dështimin e seancës. Të pesë çështjet e vëzhguara (shih dosjet 1-5) janë dokumentuar me regjistrim audio). Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar gjer tek shpallja e vendimit”.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve çështje penale themeli, civile me objekt konfiskimi, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, evidentohet si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:

**Dosja 1**, çështja me nr. regjistri 93, datë regjistrimi 21.7.2014, nr. vendimi 92, datë vendimi 2.10.2014. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, nga të cilat 1 seancë ka qenë jo produktive (për mospranimin e kërkesës për shtyrje të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit duke e konsideruar të pabazuar në ligj).

**Dosja 2**, çështja me nr. regjistri 85, datë regjistrimi 18.06.2015, nr. vendimi 99, datë vendimi 23.10.2015. Janë zhvilluar **7 seanca gjyqësore**, nga të cilat 6 seanca kanë qenë joproduktive. (për shkak të mosformimit të trupit gjykues, tre nga gjyqtarët kanë dhënë dorëheqjen dhe me vendim të KLD-së, në përbërje të trupit gjykues janë caktuar 3 anëtarë nga Gjykata e Apelit Korçë ku edhe nga ana e tyre, seancat janë shtyrë për shkak të ngarkesës të punës ku ushtrojnë detyrën).

**Dosja 3**, çështja me nr. regjistri 23, datë regjistrimi 27.01.2015, nr. vendimi 19, datë vendimi 24.02.2015. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, prej të cilave 1 seancë ka qenë jo produktive (për shkak të mosshoqërimit të të pandehurit nga ana e Drejtorisë së Burgjeve).

**Dosja 4**, çështja me nr. regjistri 41, datë regjistrimi 05.03.2015, nr. vendimi 39, datë vendimi 14.04.2015. Është zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

**Dosja 5**, çështja me nr. regjistri 63, datë regjistrimi 01.06.2016, nr. vendimi 64, datë vendimi 27.06.2016. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, gjatë së cilës gjykimi ka përfunduar me shpalljen e vendimit përfundimtar.

⋮

**Dosja 6**, çështja me nr. regjistri 83, datë regjistrimi 01.07.2014, nr. vendimi 77, datë vendimi 30.07.2014. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore** nga të cilat 1 ka qenë joproductive (*për shkak të mosparaqitjes të avokatëve mbrojtës të të pandehurve*).

**Dosja 7**, çështja me nr. regjistri 73, datë regjistrimi 22.05.2015, nr. vendimi 71, datë vendimi 29.06.2015. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, nga të cilat 1 seancë ka qenë joproductive (*për shkak të mosprezencës të avokatit mbrojtës të të pandehurit*).

**Dosja 8**, çështja me nr. regjistri 110, datë regjistrimi 02.10.2015, nr. vendimi 104, datë vendimi 09.11.2015. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, nga të cilat 1 ka qenë jo produktive (*për shkak të mosprezencës të avokatit mbrojtës të të pandehurit*).

**Dosja 9**, çështja me nr. regjistri 30, datë regjistrimi 20.01.2016, nr. vendimi 22, datë vendimi 09.03.2016. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, nga të cilat 2 kanë qenë jo produktive (*për shkak të mosprezencës të avokatit mbrojtës të të pandehurit*).

**Dosja 10**, çështja me nr. regjistri 5/125, datë regjistrimi 04.11.2015, nr. vendimi 4, datë vendimi 21.06.2016. Janë planifikuar **6 seanca gjyqësore** nga të cilat janë zhvilluar 3 kanë qenë jo produktive (*për shkak të mosprezencës së avokatëve mbrojtës të të pandehurve*).

**Dosja 11**, çështja me nr. regjistri 44, datë regjistrimi 09.03.2016, nr. vendimi 30, datë vendimi 31.03.2016. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, gjatë së cilës gjykimi ka përfunduar me shpalljen e vendimit përfundimtar.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në çështjet e vëzhguara varion nga 1 deri në 7 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 11 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë me i vogël se 3.

Nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe vetëm në një rast konstatohet që seanca të jetë shtyrë për shkak të mos shoqërimit të të pandehurit nga ana e Drejtorisë së Burgjeve (dosja 3).

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosfomimit të trupit gjykues, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt (dosja 2). Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si; lënia kohë e mbrojtësit të zgjedhur nga i pandehuri për të përgatitur përfaqësimin dhe për të parashtruar pretendimet<sup>3</sup>, shtyrjen e shpalljes së arsytuar të vendimit,<sup>4</sup>. Në çdo rast te shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, të përcaktuara në nenin 342 paragrafi 2 i K.Pr.Penale. Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore, konstatohet respektimi në çdo rast i afatit ligjor për caktimin e seancave (*afati 10 ditor për caktimin e seancës gjyqësore sipas parashikimeve të nenit 333 paragrafi i 1 të K.Pr.Penale, afati 15 ditor për caktimin e seancës gjyqësore sipas nenit 342 paragrafi 2 i K.Pr.Penale*).

<sup>3</sup>Dosja nr.4, çështja me nr. 41 regjistri, datë 05.03.2015 regjistrimi, nr. 39 vendimi, datë 14.04.2015.

<sup>4</sup>Dosja nr.5, çështja me nr. 5/125 regjistri, datë 01.11.2015 regjistrimi, nr. 4 vendimi, datë 21.06.2016.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet është më i vogël se 3 dhe gjyqtarja në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

### ***2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në të 5 çështjet gjyqësore, ajo ka marrë masat për planifikimin e seancës gjyqësore në kohën e duhur, duke respektuar edhe të drejtën e palëve për t’u përgatitur për gjykim. Në të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar respektimi i afateve ligjore të nenit 333 të K.Pr.Penale në caktimin e seancës së parë, si dhe në dërgimin e njoftimeve për palët. Po ashtu, në rastet kur gjykimi është zhvilluar me më shumë se 1 seancë, ajo ka planifikuar seancën e radhës përgjithësisht brenda afatit 15 ditor të përcaktuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale... ”.*

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, evidentohet si më poshtë: *Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, në çdo rast brenda afatit ligjor 10 ditor nga data e shortit, në përputhje me parashikimet e nenit 333 të K.Pr.Penale. Në 11 dosjet e vëzhguara rezulton se gjyqtarja ka caktuar datën e seancës së parë gjyqësore, brenda ditës së caktimit në 3 prej tyre (dosja 2,6,8), është caktuar 1 ditë pas caktimit në 7 prej tyre (dosja 1,4,5,7,9,10,11) dhe brenda 3 ditëve në 1 prej tyre (dosja 3). Në veprimet të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtarja kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale duke urdhëruar kalimin për shqyrtim të çështjes dhe caktimin e seancë gjyqësore, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur dhe me regjistrim audio. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Penale dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relativisht lidhur me momentin procedural të çështjes; disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së pandehurit pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve që kanë bërë ankim;*

dhënien e fjalës palëve për pretendime përfundimtare, deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, tërheqjen e gjyqtës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar. Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur kryesisht deri në 10 minuta vonesë, me përjashtim të tre rasteve, në të cilat seancat kanë filluar 31 min me vonesë (shih dosjen 2), 15 min me vonesë (shih dosjen 3), 18 min me vonesë (shih dosjen 10), në të cilat gjykata ka relatuar shkakun e fillimit të tyre me vonesë. Seancat gjyqësore janë zhvilluar duke u regjistruar në sistem audio.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarës janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

## **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

### ***2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato përgjithësisht kanë qënë të rregullta, të sakta dhe të plota. Në dosje janë përfshirë rregullisht vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, procesverbali i seancës gjyqësore, kërkesat me shkrim të palëve dhe aktet shkresore të paraqitura prej tyre, si dhe vendimi gjyqësor...”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes konstatohet se, aktet në dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjes ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre. Renditja e dosjes fillon me aktin e regjistrimit të çështjes në gjykatë, biletën e shortit elektronik, vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, pretendimet, diskutimet përfundimtare, procesverbalet e seancave gjyqësore, vendimi gjyqësor përfundimtar dhe procesverbali



Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
96	Shkëlqyeshëm

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3. A Etika në punë

##### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Sipas të dhënave nga regjisti i ankesave, konstatohet se ndaj gjyqtarës {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoriatin e KLD-së. Ndërsa nga të dhënat e regjistrit për

⋮

*procedimet disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”.*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë masë disiplinore. Gjithashtu, sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, konstatohet se ndaj gjyqtarës {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoriatin e KLD-së.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cënim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës, gjatë ushtrimit të funksionit.

**Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

### **3. B Integriteti i gjyqtarit**

#### ***3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave dhe hetimin disiplinor të nisur gjatë periudhës së vlerësimit (analizuar në treguesin më sipër), nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që çenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

### 3. C Paanësia e gjyqtarit

#### 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Në 1 dosje është konstatuar se ajo ka shqyrtuar çështje penale për kryerjen e veprës penale “të trafikimit të narkotikeve e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë”, “grup i strukturuar kriminal”, dhe “kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, ku ka zbatuar rregullat procedurale me kujdes për pavlefshmerinë absolute të akteve që lidhen me thirrjen e të pandehurit, e parashikuar në germën “c”, pika 1, te nenit 128 të K.Pr.Penale është e asaj shkalle saqë nuk mund të riparohet me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në Apel sipas nenit 427/4 i K.Pr.Penale. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale, me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme”.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja, në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana gjyqtares. Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtarja, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në



.....  
mënyrë të drejtëpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit si dhe në përmbajtjen e veprimëve të hartuara prej saj.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

⋮

#### 4.A Aftësia e komunikimit.

##### *4.A. a Komunikimi i qartë dhe transparent.*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqjësore në seancat gjyqësore. Në rastin kur i drejtohet të tretëve me shkresa, komunikimi është i qartë dhe i sjellshëm. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e saj. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtares dhe as kërkesa të vetë gjyqtares për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes”*.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët është e qartë, transparente dhe e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar pretendimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësore, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

##### *4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

**Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtarja në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar**

*4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësitë e gjyqtares në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

*4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### ***4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar vërtetimit me nr. 452/1/1 prot, datë 18.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklaramentit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, rezulton se ajo ka marrë pjesë në 21 trajnime profesionale, nga të cilat 10 trajnime si ekspert, 2 trajnime si moderatore, 1 trajnim si lehtësuese dhe 8 trajnime si pjesëmarrëse. Gjyqtarja për periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë në 37 ditë në programin e Trajnimit Vazhdues.

Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnime të tjera jashtë Shkollës së Magjistraturës si më poshtë;

- Takim me rrjetin Gjyqësor të Vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, organizuar nga Instituti CEELI, në Prag, Çeki me 16-17 qershor 2014;
- Seminar “Roli i gjyqtarit kombëtar në Bashkëpunimin Gjyqësor Evropian, në çështjet penale”, i organizuar nga EIPA, në Luksemburg, me 25-26 qershor 2015;
- Konferenca “Gratë gjyqtare dhe shteti i së drejtës: Vlerësimi i së shkuarës, duke parashikuar të ardhmen”, organizuar nga Shoqata Kombëtare e Grave Gjyqtare në USA, me 26-29 maj 2016;
- Seminar “Gjykimi i çështjeve gjyqësore që përfshijnë terrorizmin dhe sigurinë kombëtare”, më 15-17 qershor 2016.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës penale, gjithsej 21 aktivitete të

zhvilluara për 37 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tri vjeçare.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 20 pikë.

***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e SH.M, nga të cilat, 10 si eksperte, 1 si lehtësuese dhe 2 si moderatore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, është angazhuar në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e SH.M, nga të cilat, 10 si eksperte, 1 si lehtësuese dhe 2 si moderatore.

**Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja, vlerësohet me 5 pikë.

***4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtaren nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar

Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 3 pikë.

#### ***4.C.ç Publikimet ligjore akademike.***

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka marrë pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Gjyqtari në Demokraci”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, duke referuar me temën: “Përgjegjshmëria e gjyqtarëve përkundrejt pavarësisë dhe paanësisë së tyre”. Referimet e kësaj konference, janë botuar nga Shkolla e Magjistraturës në revistën juridike shkencore “Jeta Juridike”, botuar në vitin 2016, me numër identifikimi ISSN 2219-4134.

**Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi;** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 2 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT**

•  
•  
•  
•  
•  
•  
•

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm